



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1281 prot

Shkodër, më 27.03.2025

VENDIM


Nr 107 datë 27.03.2025

**PËR KRYERJEN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK,
NR. 207, DATË 25.09.2023 "PËR FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES
NË KONFERENCA SHKENCORE TË STAFIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË
SHKODRËS 'LUIGJ GURAKUQI'**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, shkronja c); neni 38, pika 1, shkronja k); neni 38; Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 5, pika 3, gërma c); me propozim të Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimi me nr. 1234 prot., datë 25.03.2025, për kryerjen e disa ndryshimeve në Vendimin e SA nr. 207, datë 25.09.2023 "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 27.03.2025:

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit, në fund të fjalisë, përcaktimi vit akademik, ndryshohet në "vit buxhetor".
2. Pika 1, gërma d) shfuqizohet.
3. Në pikën 1, gërma e/2), në fund të fjalisë, të shtohet përcaktimi: "ose i dytë".
4. Pika 1, gërma e/5 riformulohet si vijon:
Të informojë Drejtorinë e Investimeve dhe Prokurimeve të paktën 2 (dy) javë para, për pjesëmarrje në konferencë, me qëllim pagesën e fee-së dhe biletave të transportit me vlerë sa më të ulët.
5. Pika 1, gërma e/6 riformulohet si vijon:



"Të përcaktojnë Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" si institucion të përkatësisë (affiliation), në botimin e artikullit ose në programin e konferencës/ proceedings/ librin e abstrakteve"

6. Pika 1, gërma e/ 10 shfuqizohet.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zëvendësrektori i Kërkimit Shkencor, Administratori, Drejtoria e Financës dhe Realizimit të buxhetit; Drejtoria e Fondit të Investimeve dhe Shërbimeve.
8. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof. dr. Tonin Gjura

